VENDIM
Nr. 10, datë 26.2.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 57, pika 2, nenit 58, shkronjat "b" dhe "c", neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 31, datë 30.4.2008 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 dhjetor 2014.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i kritereve për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ndërmjet tyre ose me bankën, për qëllim të administrimit të rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe

b) nenit 57, pika 2 të nenit 58, shkronjat "b" dhe "c", neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" (këtu e më poshtë për thjeshtësi rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit).

2. Ekspozime ndaj një skeme janë ekspozimet që klasifikohen, sipas rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, në klasat e mëposhtme të ekspozimit:

a) ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (*securitization*);

b) ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

c) zëra të tjerë.

KREU II
LLOGARITJA E EKSPOZIMEVE TË MËDHA

Neni 5
Ekspozimet

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi, grupi personash të lidhur ose një pale të tretë, llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2. Bankat, në rastet kur janë të detyruara të llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e tregut, në përputhje me kreun VII të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, përcaktojnë edhe vlerën e ekspozimeve në zërat e librit të tregtueshëm dhe ekspozimin në tërësi, ndaj një personi ose grupi personash të lidhur sipas nenit 165, paragrafi 3 të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit.

3. Bankat llogarisin ekspozimin në tërësi ndaj një personi ose një grupi personash të lidhur, si shumë e ekspozimeve në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm.

4. Ekspozimi ndaj një grupi personash të lidhur është shuma e ekspozimeve ndaj personave, që përbëjnë grupin e personave të lidhur.

5. Bankat, në përcaktimin e grupit të personave të lidhur, në rastin e ekspozimeve ndaj një skeme, vlerësojnë skemën si një të tërë, ekspozimet bazë ose së bashku (skemën dhe ekspozimet).

6. Bankat, në zbatim të kërkesave të pikës 5 të këtij neni, vlerësojnë natyrën ekonomike dhe rreziqet që mbart struktura e transaksionit, dhe përdorin një nga mënyrat e

përcaktuara në aneksin 1, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

7. Bankat, në llogaritjen e vlerës së ekspozimit në librin e bankës, marrin në konsideratë vlerën kontabël për zërat e aktivit (vlerën në bilanc pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve) dhe vlerën e zërave jashtë bilancit, përpara klasifikimit në kategoritë e rrezikut.

8. Bankat, në llogaritjen e vlerës së ekspozimeve që rrjedhin nga instrumente derivative, të përcaktuara në aneksin 4 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, përdorin një nga metodat e përcaktuara në kreun VI të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit (rreziku i kredisë së kundërpartisë).

9. Bankat, pavarësisht përcaktimeve të mësipërme të këtij neni, nuk konsiderojnë si pjesë të ekspozimit, zërat që përbëjnë elemente zbritëse të kapitalit rregullator të bankës.

10. Bankat, pavarësisht përcaktimeve të mësipërme të këtij neni, nuk përfshijnë në llogaritjen e ekspozimit:

a) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transaksioneve të këmbimit valutor, që krijohen gjatë aktivitetit normal të shlyerjes, përgjatë dy ditëve pune;

b) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transaksioneve të shitblerjes së letrave me vlerë, që krijohen gjatë aktivitetit normal të shlyerjes përgjatë pesë ditëve pune të kryerjes së pagesës ose dorëzimit të letrës me vlerë, cilado qoftë më e hershmja;

c) ekspozimet (pagesat në proces), në rastin e transfertave të parave (përfshirë ekzekutimin e shërbimeve të pagesave, klerimin dhe shlyerjen në monedha të ndryshme dhe banka të ndryshme korrespondente), si dhe ekspozimet që krijohen brenda ditës ndaj institucioneve që ofrojnë këto shërbime.

Neni 7
Ekspozimet e mëdha

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi ose grupi personash të lidhur mes tyre ose me bankën, konsiderohet i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10 për qind e kapitalit rregullator të saj.

2. Bankat llogarisin ekspozimet e mëdha, përpara aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë dhe përjashtimeve apo reduktimeve, të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

KREU III
LLOGARITJA E EKSPOZIMEVE MAKSIMALE

Neni 8
Ekspozimi maksimal i lejueshëm

1. Bankat respektojnë në çdo kohë kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh, të përcaktuar në nenin 64 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, si dhe kufizimet në lidhje me dhënien e kredive të përcaktuara sipas nenit 131 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2. Bankat llogarisin ekspozimin maksimal të lejueshëm pas aplikimit të teknikave të zbutjes dhe përjashtimeve apo reduktimeve, siç përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli Drejtues i bankës përcakton rregulla të veçanta, në lidhje me dhënien e kredive personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën, për monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të tyre, në përputhje me nenin 63, pika 3 dhe nenin 65 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 9
Përjashtimet dhe reduktimet

1. Bankat, në rastet kur përdorin mbrojtjen e financuar apo të pafinancuar të kredisë, e cila rezulton në përjashtimin, tërësisht ose pjesërisht, të një ekspozimi apo në reduktimin e tij, duhet të plotësojnë kërkesat e njohjes dhe të gjitha kërkesat minimale siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit (përfshirë këtu dhe derivativët e kredisë, por duke përjashtuar *credit linked notes*).

2. Bankat, në llogaritjen e ekspozimeve maksimale të lejueshme, përjashtojnë, tërësisht ose pjesërisht, ekspozimet e mëposhtme:

a) ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore, të cilave u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare dhe bankave shumëpalëshe (multilaterale) të zhvillimit, të cilave u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

c) ekspozimet e garantuara shprehimisht nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, organizatat ndërkombëtare, bankat shumëpalëshe (multilaterale) të zhvillimit apo njësi të sektorit publik, në kushtet kur ekspozimeve të ofruesit të garancisë, u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

d) ekspozimet e tjera, që mund të klasifikohen si ekspozime ndaj njësive të përcaktuara në shkronjën "c" të këtij paragrafi apo që janë të garantuara nga njësitë e përcaktuara në shkronjën "c" të këtij paragrafi, kur ekspozimeve ndaj njësive të tilla u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

e) ekspozimet ndaj ose të garantuara nga qeveritë rajonale apo autoritetet lokale, të cilave u caktohet një peshë rreziku 0%, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

f) ekspozimet e tjera, të siguruara me kolateral, në formën e depozitave, të vendosura në bankën që llogarit ekspozimin, ose filialin e saj apo bankën-mëmë të saj, si edhe:

i) *cash*-i i pranuar në rastin e lëshimit të *credit-linked* notes të lëshuara nga banka; dhe

ii) kreditë e dhëna nga banka dhe depozitat me bankën, që janë subjekt i netimit të zërave në bilanc, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

g) ekspozimet e tjera të siguruara me kolateral, në

formën e certifikatave të depozitës, të emetuara dhe të regjistruara nga banka që llogarit ekspozimin, ose filiali i saj apo banka-mëmë e saj;

h) ekspozimet që lindin nga angazhime kredie të patërhequra, që janë të klasifikuara si zëra jashtë bilancit pa rrezik (aneksi 2 i rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit), me kusht që të jetë nënshkruar një marrëveshje apo kontratë, në bazë të së cilës fondet nuk mund të tërhiqen, nëse tërheqja e fondeve do të shkaktonte tejkalim të limiteve, të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

i) ekspozimet ndaj kundërpartive qendrore dhe kontributet e fondeve për mbulimin e humbjeve ndaj kundërpartive qendrore;

j) investimet në obligacione të garantuara sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

k) ekspozime ndaj bursave të njohura;

l) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale të shteteve anëtare të BE-së, të cilave do t'u caktohet një peshë rreziku prej 20% dhe ekspozime të tjera ndaj apo të garantuara nga qeveritë rajonale apo autoriteteve lokale të shteteve të BE-së, të cilave do t'u caktohet një peshë rreziku prej 20%;

m) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, ndaj një kundërpartie, e cila është filiali i saj, banka e saj mëmë apo filial tjetër i bankës së saj mëmë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) kundërpartia është një bankë, e themeluar në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në Republikën e Shqipërisë;

ii) kundërpartia është e përfshirë në të njëjtën mbikëqyrje të konsoliduar si edhe banka; si dhe

iii) ekspozimet ndaj kësaj kundërpartie nuk janë pjesë e kapitalit rregullator të saj (kundërpartisë);

n) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, që krijohen nga angazhime kredie të patërhequra dhe detyrime të mundshme, që rrjedhin nga kreditë dokumentare, në të cilat dërgesa ose malli (*commodity*) shërben si kolateral, si dhe transaksione të tjera të vetëlikuidueshme, të klasifikuara si zëra jashtë bilancit, me rrezik të ulët (aneksi 2 i rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit).

3. Bankat, në llogaritjen e ekspozimeve maksimale të lejueshme, mund të përjashtojnë pjesërisht ekspozimet e mëposhtme:

a) Ekspozimet:

i) e siguruara me pasuri të paluajtshme rezidenciale;

ii) në qira financiare ndaj një qiramarrësi, të lidhura me një pasuri të paluajtshme rezidenciale, ekspozime në të cilat banka është qiradhënësi dhe qiramarrësi ka një opsion për të blerë pasurinë, me kusht që ekspozimi i bankës të jetë plotësisht dhe tërësisht i siguruar nga pronësia e tij mbi objektin;

që plotësojnë kushtet për t'u ponderuar me një peshë rreziku 35%, në përputhje me nenin 22 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Përjashtimi, në çdo rast, nuk mund të jetë më shumë se 50% e vlerës së pasurisë së paluajtshme rezidenciale (kolaterali që siguron ekspozimin), vlerë e cila duhet të llogaritet të paktën një herë në çdo tre vjet (siç përcaktohet në aneksin 1 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit).

b) Ekspozimet:

i) e siguruara me pasuri të paluajtshme tregtare;

ii) në qira financiare ndaj një qiramarrësi, të lidhur me një pasuri tregtare, sipas përcaktimeve të nenit 23 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Përjashtimi, në çdo rast, nuk mund të jetë më shumë se 50% e vlerës së pasurisë së paluajtshme tregtare (kolaterali që siguron ekspozimin), vlerë e cila duhet të llogaritet minimalisht një herë në vit (siç përcaktohet në aneksin 1 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit).

Neni 10

Ekspozimet e siguruara me garanci ose me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë

1. Bankat, në rastet kur ekspozimi ndaj një personi garantohet nga një palë e tretë, mund të trajtojnë / konsiderojnë pjesën e garantuar të ekspozimit si ekspozim ndaj garantuesit, vetëm në rast se, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit, ekspozimeve të pasiguruara të garantuesit do t'u caktohej një peshë rreziku e barabartë ose më e vogël sesa pesha e rrezikut që i caktohet një ekspozimi të pasiguruar të personit/klientit.

2. Bankat, në llogaritjen e ekspozimit ndaj garantuesit (në rastet kur zbatojnë trajtimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni), konsiderojnë kriteret e mëposhtme:

a) Nëse garancia është shprehur në një monedhë të ndryshme nga ajo e ekspozimit bazë (*underlying exposure*), shuma e ekspozimit të mbuluar llogaritet në përputhje me dispozitat për trajtimin e mospërputhjeve të monedhës në mbrojtjen e pafinancuar të kredisë, siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) Nëse ekziston një mospërputhje midis maturitetit të ekspozimit dhe maturitetit të garancisë, kjo trajtohet në përputhje me dispozitat për trajtimin e mospërputhjes së maturitetit, siç përcaktohet në kreun IV të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit; si dhe

c) Nëse mbulimi është i pjesshëm, njohja (*recognition*) realizohet siç përcaktohet në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit (kreu IV).

3. Bankat, në rastet kur ekspozimi ndaj një personi sigurohet me një kolateral të njohur, të lëshuar nga një palë e tretë, mund të trajtojnë/konsiderojnë pjesën e siguruar/kolateralizuar të ekspozimit, si ekspozim ndaj emetuesit të kolateralit, vetëm në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) kolaterali i njohur vlerësohet me çmimin e tregut;

b) pjesës së siguruar/kolateralizuar të ekspozimit do t'i caktohej një peshë rreziku, e barabartë apo më e vogël se pesha e rrezikut që do t'i caktohej një ekspozimi të

pasiguruar ndaj personit/klientit, në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit;

c) nuk ka mospërputhje midis maturitetit të ekspozimit bazë dhe maturitetit të kolateralit.

KREU IV
MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 11
Kërkesat monitoruese dhe mbikëqyrëse

1. Bankat hartojnë dhe zbatojnë politika dhe procedura për identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e ekspozimeve të mëdha, ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, që rrjedhin nga zërat në librin e bankës dhe librin e tregtueshëm.

2. Këshilli drejtues është përgjegjës, në veçanti, për vendimmarrjet në rastet e krijimit dhe ristrukturimit të ekspozimeve ndaj kredimarrësve të mëdhenj.

3. Bankat hartojnë procedura të plota administrimi dhe kontabiliteti, sisteme të përshtatshme informacioni dhe sisteme të përshtatshme të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e politikave dhe procedurave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Bankat hartojnë sisteme kontrolli të brendshëm për të parandaluar transferimet e përkohshme të ekspozimeve në fjalë, te një person tjetër dhe kryerjen e transaksioneve joreale (fiktive) për të mbyllur ekspozimin dhe krijojnë një ekspozim të ri.

5. Bankat, për qëllime të përcaktimit të rrezikut të mundshëm të përqendrimit, hartojnë politika dhe procedura për identifikimin, analizimin dhe monitorimin e ekspozimeve, ndaj lëshuesve të mbrojtjes së kredisë dhe ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë dhe ekspozimeve në formën e obligacioneve të garantuara dhe ekspozimeve ndaj skemave.

6. Bankat kryejnë analizën e rrezikut të ekspozimit ndaj kredimarrësve të mëdhenj në momentin e krijimit të ekspozimit dhe në vazhdimësi, duke u bazuar në pasqyrat financiare të certifikuara/të audituara.

7. Bankat hartojnë plane të rimëkëmbjes dhe të zgjidhjes së kredimarrësve të mëdhenj dhe i rishikojnë ato me një frekuencë jo më të vogël se një herë në vit.

8. Bankat, në rast të ekspozimit të kredimarrësve të mëdhenj në më shumë se një bankë, koordinojnë dhe marrin pjesë në punën për hartimin dhe rishikimin e planeve të përbashkëta të rimëkëmbjes dhe të zgjidhjes për këto ekspozime, edhe në rastet kur ekspozimi i tyre ndaj një kredimarrësi apo grup personash të lidhur nuk përbën kredimarrës të madh ose grup të madh për to.

Neni 12
Kërkesa raportuese

1. Bankat plotësojnë dhe dorëzojnë në fund të çdo 3-mujori (tremujori), në Bankën e Shqipërisë formularët e mëposhtëm, pjesë e aneksit 2, bashkëngjitur kësaj rregulloreje:

a) formularin nr. 1 mbi ekspozimet e mëdha;

b) formularin nr. 2 mbi ekspozimet e mëdha në tërësi;

c) formularin nr. 3 mbi ekspozimet në zërat e librit të bankës;

d) formularin nr. 4 mbi ekspozimet në zërat e librit të tregtueshëm;

e) formularin nr. 5 mbi ekspozimet e bankës ndaj personave me marrëdhënie të veçantë me bankën.

2. Grupi bankar raporton mbi baza të konsoliduara për ekspozimet maksimale të lejueshme dhe marrëdhëniet me personat e lidhur, çdo 6-mujor (gjashtëmujor). Ky raportim kryhet sipas formularëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Banka e Shqipërisë, në çdo rast që e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë dhe të urdhërojë ndryshime në përmbajtjen dhe në shpeshtësinë e raportimit.

Neni 13
Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, kur konstaton mosrespektimin, nga bankat, të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat administrative, mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore, të parashikuara në nenet 74 deri në 81 dhe në nenin 89 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

ANEKSI 1
TRAJTIMI I EKSPOZIMEVE NDAJ SKEMAVE

1. Bankat trajtojnë ekspozimet ndaj skemave, duke konsideruar/vlerësuar ekspozimin ndaj skemës si një të tërë, ndaj ekspozimit bazë (*underlying exposures*) të një skeme ose së bashku (skemën dhe ekspozimin bazë).

2. Bankat, në rast se një nga ekspozimet individuale të ekspozimeve bazë (*underlying exposures*) të skemës tejkalon 5% dhe kjo përqindje nuk ka ndryshuar konsiderueshëm ndërmjet periudhave raportuese, identifikojnë këto ekspozime bazë individuale dhe i përfshijnë ato në ekspozimin në tërësi ndaj një personi ose grupi personash të lidhur (ekspozimet individuale bazë përfshihen në ekspozimin në tërësi, në raport me përqindjen (peshën) që ato zënë ndaj ekspozimeve të skemës).

3. Bankat, pavarësisht përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij aneksi, në rastet kur provojnë që ekspozimi ndaj një skeme individuale nuk tejkalon kufijtë e lejuar të ekspozimit, të përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje, nuk janë të detyruara të identifikojnë ekspozimet bazë individuale.

4. Bankat, në rastet kur struktura e ekspozimeve bazë në një skemë është subjekt ndryshimesh të shpeshta ose kur përqindja që zë një ekspozim bazë (individualisht) në raport me ekspozimet bazë të skemës, nuk tejkalon 5% dhe kur provohet se ekspozimi ndaj një skeme individuale nuk do të rezultonte në tejkalim të kufijve të lejuar të ekspozimit, në bazë të nenit 8 të kësaj rregulloreje, nuk janë të detyruara të identifikojnë

ekspozimet bazë individuale.

5. Bankat trajtojnë ekspozimet e paidentifikuara në një skemë dhe që rrjedhimisht nuk janë përfshirë në ekspozimin ndaj një personi ose grupi personash, si ekspozime ndaj një personi "të paidentifikuar". Ekspozimi i bankave ndaj këtij personi "të paidentifikuar", nuk duhet të tejkalojë 20% të kapitalit rregullator.

6. Bankat, përjashtimisht përcaktimeve të paragrafit 5 të këtij aneksi, kur mund të provojnë se ekspozimet bazë të një skeme nuk janë të lidhura me ekspozime të tjera të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të bankës, i përfshijnë ato në ekspozimin në tërësi ndaj një personi të vetëm "të paidentifikuar", të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij aneksi. Në këtë rast, bankat do të konsiderojnë ekspozimin ndaj kësaj skeme si ekspozim ndaj një klienti të veçantë, "të paidentifikuar" (jo klienti kolektiv, por klient i paidentifikuar i krijuar posaçërisht për këtë skemë).

7. Bankat në asnjë rast nuk mund të përdorin (abuzojnë) në zgjedhjen e mënyrës për trajtimin e ekspozimeve, me qëllim që të shmangin respektimin e kufijve për ekspozimin maksimal të lejueshëm, si dhe në çdo rast vërtetojnë se vendimi për të zbatuar një prej trajtimeve të përmendura në paragrafët 2 deri në 6 të këtij aneksi është bërë në bazë të vlerësimit të natyrës ekonomike dhe rreziqeve që mbartin këto ekspozime / transaksione.

8. Bankat, nëse identifikojnë ekspozimet bazë individuale në një skemë, monitorojnë rregullisht dhe minimalisht në baza mujore, strukturën e ekspozimeve të skemës respektive.

ANKESI 2

_____
(emri i bankës)

RAPORT MBI EKSPOZIMIN E MADH
Data e raportimit: _____

I. Llogaritja e kufijve

Kapitali rregullator[1] në datën e raportimit
= _____

Ekspozimi i madh **≥ 10% e**
kapitalit rregullator **≥** _____

Ekspozimi i madh i lejuar ndaj personave me marrëdhënie të veçantë me bankën **10% e kapitalit**
rregullator **=** _____
Ekspozimi i madh i lejuar **20% e kapitalit**
rregullator **=** _____
Ekspozimi i madh i lejuar ndaj bankës mëmë, filialeve ose filialeve të bankës mëmë **25% e kapitalit**
rregullator **=** _____

Kufiri i lejuar i ekspozimeve të mëdha, të marra së bashku[2] 700% e kapitalit rregullator
= _____

II. Tejkalimi i kufijve[3]
III. Tejkalimi i kufirit për ekspozimet e mëdha, të marra së bashku[4]

Data: _____

Përgatitur nga: _____ **Vula**
dhe firma e personit përgjegjës:

[1] Përllogaritet në përputhje me paragrafin 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.
[2] Në referencë të nenit 64, paragrafi 4 i ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
[3] Tejkalimet e kufirit të ekspozimit të madh [emri i personit (klient/mëma/filial/filial i mëmës), shuma e raportuar në kolonën 10 të formularit të raportimit nr. 1, përqindja (%) ndaj kapitalit rregullator të bankës, të raportuar në kolonën 11 të formularit të raportimit nr. 1 dhe arsyet për çdo tejkalim].
[4] Diferenca (kur është pozitive) midis totalit të kolonës 4 në formularin e raportimit nr. 1 dhe kufirit maksimal të lejuar (700% të kapitalit rregullator).

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

_____

(emri i bankës) **EKSPOZIMET E MËDHA** _____

Data e raportimit: _____

Nr.	Emri i klientit	Numri i identifikimit të klientit	Kodi për institucionet financiare (“IF”)	Ekspozimi përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Nga i cili: ekspozimi i ardhur nga zëvendësimi	% ndaj kapitalit rregullator	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Mbrojtja e financuar e kredisë	Përjashtime të tjera	Ekspozimi pas përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë 10 = 4-(7+8+9)	% ndaj kapitalit rregullator	Limiti
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	I. Personat/klientët individualë											
	II. Grupe të personave të lidhur											

1. Personat ose grupet e personave të lidhur (në mënyrë të detajuar), për të cilët shuma në kolonën 4 arrin ose tejkalon 10% të kapitalit rregullator të bankës. Personat e përfshirë në pjesën II (grupet e personave të lidhur) nuk do të raportohen në pjesën I (personat/klientët individualë), megjithëse ekspozimi ndaj atij klienti mund të tejkalojë 10% të kapitalit rregullator.
2. Numri i identifikimit të klientit.
3. Kodi "IF" plotësohet në rastet e ekspozimeve ndaj institucioneve financiare.
4. Shuma e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje, e zmadhuar për shumën e ekspozimit, si rezultat i zëvendësimit, sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje (pjesë nga ekspozimi i garantuar nga një palë e tretë ose i siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, i cili është trajtuar si ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit).
5. Pjesa e ekspozimit e garantuar nga një palë e tretë ose e siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila trajtohet si një ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit, përdorimi i zëvendësimit në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje (shuma e përfshirë në kolonën 4).
6. Vlera në kolonën 4, krahasuar me kapitalin rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).
7. Shuma e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, e cila, në përputhje me germën "c", pjesërisht pikën "d", pjesërisht pikën "e" të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafin 2 të nenit 10, mund të përdoret për të përcaktuar nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
8. Shuma e mbrojtjes së financuar të kredisë, e cila, në përputhje me germat "f" dhe "g" të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafit 3 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, mund të përdoren kur përcaktohet nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
9. Shuma e përjashtimeve në përputhje me germat "a", "b", pjesërisht germa "d", pjesërisht germa "e", germat "h", "i", "j", "k", "l", "m" dhe "n" të paragrafit 2 të nenit 9, si dhe germat "a" dhe "b" të paragrafit 3 të nenit 9.
10. Vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje (pas përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë).
11. Vlera në kolonën 10, e krahasuar me shumën e kapitalit rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).
12. Limiti i ekspozimit të madh, i vlefshëm/lejuar, për personat ose grupet e personave të lidhur. Në rastin e një grupi të personave të lidhur, të raportuar në pjesën II, limiti raportohet në çdo rresht.

_____
(emri i bankës)

RAPORT MBI EKSPOZIMIN E MADH NË TËRËSI[5]

Data e raportimit: _____

I. Përllogaritja e kufijve

Kapitali rregullator[6] në datën e raportimit
= _____

[5] Ekspozime në zëra të librit të bankës dhe të librit të tregtueshëm.
[6] Përllogaritet në përputhje me paragrafin 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Ekspozimi i madh **≥ 10% e kapitalit rregullator**
≥ _____

Ekspozimi i madh i lejuar ndaj personave me marrëdhënie të veçantë me bankën **10% e kapitalit rregullator**
= _____
Ekspozimi i madh i lejuar **20% e kapitalit rregullator**
= _____
Ekspozimi i madh i lejuar ndaj mëmës, filialeve ose filialeve të bankës mëmë **25% e kapitalit rregullator** =
_____

Kufiri i lejuar i ekspozimeve të mëdha, të marra së bashku: 700% e kapitalit rregullator
= _____

II. Tejkalimi i kufijve[7]

III. Tejkalimi i kufirit për ekspozimet e mëdha në tërësi, të marra së bashku[8]

Data: _____

Përgatitur nga: _____ **Vula dhe firma e personit përgjegjës:**

[7] Tejkalimet e limiteve të ekspozimit të madh në tërësi [emri i personit (klient/mëmë/filial/filial i mëmës), shuma e raportuar në kolonën 12 të formularit të raportimit nr. 2, përqindja (%) ndaj kapitalit rregullator të bankës, të raportuar në kolonën 13 të formularit të raportimit nr. 2 dhe arsyet për çdo tejkalim].

[8] Diferenca (kur është pozitive), midis totalit të kolonës 6 në formularin e raportimit nr. 2 dhe kufirit maksimal të lejuar (700% të kapitalit rregullator).

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 2

_____
(emri i bankës)

EKSPOZIMET E MËDHA NË TËRËSI

Data e raportimit _____

Numri i identifikimit të klientit	Kodi për institucionet financiare ("IF")	Ekspozimi përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (libri i bankës)	Ekspozimi përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë (libri i tregtueshëm)	Ekspozimi përgjithshëm përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rezikut të kredisë 6 = 4+5	Nga i cili: ekspozimi i ardhur nga zëvendësimi (libri i tregtueshëm dhe libri i bankës)	% ndaj kapitalit rregullator	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Mbrojtja e financuar e kredisë	Përjashtime të tjera	Ekspozimi i përgjithshëm pas përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë 12= 6-(9+10+11)
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

1. Personat ose grupet e personave të lidhur (në mënyrë të detajuar), për të cilat shuma në kolonën 6 arrin ose tejkalon 10% të kapitalit rregullator të bankës. Personat e përfshirë në pjesën II. (Grupet e personave të lidhur) nuk do të raportohen në pjesën I. (Personat/klientët individualë), megjithëse ekspozimi ndaj atij klienti mund të tejkalojë 10% të kapitalit rregullator.
2. Numri i identifikimit të klientit.
3. Kodi "IF" plotësohet në rastet e ekspozimeve ndaj institucioneve financiare.
4. Shumat e raportuara në kolonën 4 të formularit nr. 3 (ekspozimet në librin e bankës, përpara përjashtimeve dhe teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë).
5. Shumat e raportuara në kolonën 7 të formularit nr. 4 (ekspozimet në librin e tregtueshëm, përpara përjashtimeve dhe teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë).
6. Totali i kolonave 4 dhe 5.
7. Pjesa e ekspozimit, e garantuar nga një palë e tretë ose e siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila trajtohet si një ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit, përdorimi i zëvendësimit në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje (shuma e përfshirë në kolonën 4).
8. Vlera në kolonën 6, krahasuar me shumën e kapitalit rregullator të bankës.
9. Shuma e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, e cila, në përputhje me germat "c", pjesërisht germën "d", pjesërisht germën "e" të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafin 2 të nenit 10, mund të përdoret për të përcaktuar nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.

10. Shuma e mbrojtjes së financuar të kredisë, e cila, në përputhje me germat “f” dhe “g” të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafin 3 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, mund të përdoren kur përcaktohet nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
11. Shuma e përjashtimeve në përputhje me germat “a”, “b”, pjesërisht germa “d”, pjesërisht germa “e”, germat “h”, “i”, “j”, “k”, “l”, “m” dhe “n” të paragrafit 2 të nenit 9, si dhe germat “a” dhe “b” të paragrafit 3 të nenit 9.
12. Vlera e ekspozimit e llogaritur në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje (pas përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë).
13. Vlera në kolonën 12, e krahasuar me shumën e kapitalit rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).
14. Limiti i ekspozimit të madh, i vlefshëm/lejuar, për personat ose grupet e personave të lidhur. Në rastin e një grupi të personave të lidhur, të raportuar në pjesën II, limiti raportohet në çdo rresht.

FORMULARI I RAPORTIMIN NR. 3

_____
(emri i bankës)

EKSPOZIMET E MËDHA NË TËRËSI
Data e raportimit _____

mri i klientit	**Numri i identifikimit të klientit**	**Kodi për institucionet financiare (“IF”)**	**Ekspozimi përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë**	**Nga të cilat: ekspozimi i ardhur nga zëvendësimi (libri i bankës)**	**% ndaj kapitalit rregullator**	**Mbrojtja e pafinancuar e kredisë**	**Mbrojtja e financuar e kredisë**	**Përjashtime të tjera**	**Ekspozimi pas përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë 10 = 4-(7+8+9)**	**% ndaj kapitali rregullat**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
sonat										
upet e personave ur										

1. Personat ose grupet e personave të lidhur (me detaje mbi përbërjen e grupit), për të cilat shuma në kolonën 6 të formularit nr. 2, arrin ose tejkalon 10% të kapitalit rregullator të bankës. Personat e përfshirë në pjesën II. (Grupet e personave të lidhur) nuk do të raportohen në pjesën I, megjithëse ekspozimi ndaj atij personi mund të tejkalojë 10% të kapitalit rregullator.
2. Numri i identifikimit të klientit.
3. Kodi "IF" plotësohet në rastet e ekspozimeve ndaj institucioneve financiare.
4. Shuma e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje, e zmadhuar për shumën e ekspozimit, si rezultat i zëvendësimit të përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje (pjesë nga ekspozimi i garantuar nga një palë e tretë ose i siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, i cili është trajtuar si ekspozim ndaj garantorit ose lëshuesit të kolateralit).
5. Pjesa e ekspozimit e garantuar nga një palë e tretë ose e siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila trajtohet si një ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit, përdorimi i zëvendësimit në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje (shuma e përfshirë në kolonën 4).
6. Vlera në kolonën 4, krahasuar me kapitalin rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).
7. Shuma e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, e cila, në përputhje me germën "c", pjesërisht germën "d", pjesërisht germën "e" të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafin 2 të nenit 10, mund të përdoret për të përcaktuar nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
8. Shuma e mbrojtjes së financuar të kredisë, e cila, në përputhje me germat "f" dhe "g" të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafin 3 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, mund të përdoren kur përcaktohet nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
9. Shuma e përjashtimeve në përputhje me germat "a", "b", pjesërisht germa "d", pjesërisht germa "e", germat "h", "i", "j", "k", "l", "m" dhe "n" të paragrafit 2 të nenit 9, si dhe germat "a" dhe "b" të paragrafit 3 të nenit 9.
10. Vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje (pas përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë).
11. Vlera në kolonën 10, e krahasuar me shumën e kapitalit rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).
12. Limiti i ekspozimit të madh, i vlefshëm/lejuar, për personat ose grupet e personave të lidhur. Në rastin e një grupi të personave të lidhur, të raportuar në pjesën II, limiti raportohet në çdo rresht.

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 4

_____

(emri i bankës)

EKSPOZIMI NË ZËRAT E LIBRIT TË TREGTUESHËM

Data e Raportimit: _____

Emri i klientit	**Numri i identifikimit të klientit**	**Kodi për institucionet financiare (“IF”)**	**Pozicionet në instrumente financiare**	**Pozicionet në instrumente financiare në rast të nënshkrimit me premtimin për të blerë**	**Ekspozimi i rrezikut të kredisë së kundërpartisë**	**Ekspo përjas zbutjes kre tregtue**
1	2	3	4	5	6	
hat e të personave të lidhur			Në blerje Në shitje Në blerje neto	Premtimi për të blerë Transferuar një personi të tretë Diferenca		

1. Personat ose grupet e personave të lidhur me bankën, për të cilat shuma në kolonën 6 të formularit nr. 2, arrin ose tejkalon, 10% të kapitalit rregullator të bankës. Personat e përfshirë në pjesën II. (Grupet e personave të lidhur nuk do të raportohen në pjesën I, megjithëse ekspozimi ndaj atij personi mund të tejkalojë 10% të kapitalit rregullator.
2. Numri i identifikimit të klientit ose ndonjë kod tjetër.
3. Kodi "IF" plotësohet në rastet e ekspozimeve ndaj institucioneve financiare.
4. Vlera e pozicioneve në blerje dhe në shitje, e të gjitha instrumenteve financiare, të lëshuara nga personi/klienti në fjalë, ku pozicionet neto, për secilin instrument financiar, janë përllogaritur në përputhje me rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit (kreu VII "Rreziku i tregut"). Kur përllogaritet ekspozimi ndaj një personi/klienti individual, si rezultat i pozicioneve në instrumente të ndryshme financiare, mblidhen pozicionet neto për instrumentet e ndryshme financiare të këtyre personave/klientëve.
5. Shuma e ekspozimit që lind nga angazhimi për të blerë instrumente financiare të personave/klientëve individualë, në rastin e përgatitjes dhe finalizimit të nënshkrimit, e reduktuar për shumën e instrumenteve financiare, të cilat u janë transferuar, tashmë, palëve të treta, dhe ekspozimi neto i përllogaritur (diferenca).
6. Ekspozimet ndaj një personi/klienti individual, si rezultat i transaksioneve, marrëveshjeve ose kontratave, që kanë të bëjnë me rrezikun e kundërpartisë, të përllogaritura në përputhje me metodën standarde, në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit.
7. Totali i shumave në kolonat 4, 5 dhe 6, që përfaqësojnë ekspozimet në zërat e librit të tregtueshëm.

_____
(emri i bankës)

RAPORT MBI EKSPOZIMIN E MADH NDAJ PALËVE TË LIDHURA ME BANKËN

Data e raportimit: _____

IV. Llogaritja e kufijve

Kapitali rregullator[9] në datën e raportimit
= _____

Ekspozimi i madh rregullator **≥** _____ **≥ 10% e kapitalit**

[9] Përllogaritet në përputhje me paragrafin 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Ekspozimi i madh i lejuar ndaj personave me marrëdhënie të veçantë me bankën **10% e kapitalit rregullator**
= **_____**

Kufiri i lejuar i kredive, për dhe në përfitim të personave të lidhur me bankën[10] **100% e kapitalit rregullator** **=** **_____**

V. **Tejkalimi i kufirit për ekspozimet e mëdha**[11]

VI. **Tejkalimi i kufirit të lejuar të kredive, për dhe në përfitim të personave të lidhur me bankën**[12]

Data: **_____**

Vula dhe firma e personit përgjegjës:

[10] Kërkesë e nenit 131 të ligjit për bankat.

[11] Tejkalimet e kufirit të ekspozimit të madh [emri i personit/shuma e raportuar në kolonën 11 të formularit të raportimit nr. 5, përqindja (%) ndaj kapitalit rregullator të bankës, të raportuar në kolonën 12 të formularit të raportimit nr. 5 dhe arsyet për çdo tejkalim].

[12] Diferenca pozitive, midis totalit të kolonës 5 dhe kufirit maksimal të lejuar (100% e kapitalit rregullator).

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 5

_____
(emri i bankës)

EKSPOZIMET NDAJ PERSONAVE ME NJË MARRËDHËNIE TË VEÇANTË ME BANKËN

Data e raportimit _____

Nr.	Emri	Numri i identifikimit të klientit	Kodi për institucionet financiare ("IF")	Ekspozimi përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	Nga i cili: shuma e kredive	Nga i cili: ekspozimi i ardhur nga zëvendësimi	% ndaj kapitalit rregullator	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Mbrojtja e financuar e kredisë	Përjashtime të tjera	Ekspozimi pas përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë 11 =4-(8+9+10)	% ndaj kapitalit rregullator	Limiti
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
	I. Personat (me marrëdhënie të veçantë me bankën)												
	II. Grupe të personave me marrëdhënie të veçantë me bankën												

1. Personat ose grupet e personave të lidhur (në mënyrë të detajuar) për të cilat shuma në kolonën 4 arrin ose tejkalon 10% të kapitalit rregullator të bankës. Personat e përfshirë në pjesën II përfaqësojnë institucione financiare. Personat e përfshirë në pjesën II (grupet e personave të lidhur) nuk do të raportohen në pjesën I. (Personat/klientët individualë), megjithëse ekspozimi ndaj atij klienti mund të tejkalojë 10% të kapitalit rregullator.
2. Numri i identifikimit të klientit.
3. Kodi "IF" plotësohet në rastet e ekspozimeve ndaj institucioneve financiare.
4. Shuma e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje, e zmadhuar për shumën e ekspozimit, si rezultat i zëvendësimit sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje (pjesë nga ekspozimi i garantuar nga një palë e tretë ose i siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila është trajtuar si ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit).
5. Shuma e kredive (shuma e përfshirë në kolonën 4).
6. Pjesa e ekspozimit, e garantuar nga një palë e tretë ose e siguruar me kolateral të lëshuar nga një palë e tretë, e cila trajtohet si një ekspozim ndaj garantuesit ose lëshuesit të kolateralit, përdorimi i zëvendësimit në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje (shuma e përfshirë në kolonën 4).
7. Vlera në kolonën 4, krahasuar me kapitalin rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).

8. Shuma e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, e cila, në përputhje me germën “c”, pjesërisht germën “d”, pjesërisht germën “e” të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafin 2 të nenit 10, mund të përdoret për të përcaktuar nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
9. Shuma e mbrojtjes së financuar të kredisë, e cila, në përputhje me germat “f” dhe “g” të paragrafit 2 të nenit 9 dhe paragrafit 3 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, mund të përdoren kur përcaktohet nëse janë arritur limitet maksimale të lejueshme të ekspozimit.
10. Shuma e përjashtimeve, në përputhje me germat “h” dhe “o” të paragrafit 2 të nenit 9, si dhe germat “a” dhe “b” të paragrafit 3 të nenit 9.
11. Vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me kreun III të kësaj rregulloreje (pas përjashtimeve dhe aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë).
12. Vlera në kolonën 11, e krahasuar me shumën e kapitalit rregullator (% ndaj kapitalit rregullator).
13. Limiti i ekspozimit të madh, i vlefshëm/lejuar, për personat ose grupet e personave të lidhur. Në rastin e një grupi të personave të lidhur, të raportuar në pjesën II, limiti raportohet në çdo rresht.